



Udhëzimi 32

Shtator 2016

Prokurimi publik

Analiza e tregut, konsultimet paraprake e tregut, dhe përfshirja paraprake e kandidatëve/ofertuesve

PËRMBAJTJA

- [Hyrie](#)
- [Angazhimi i drejtpërdrejtë e operatorëve ekonomik, si pjesë e analizës së tregut](#)
- [Vendimi për të angazhuar drejtpërsëdrejti operatorët ekonomik](#)
- [Identifikimi i operatorëve ekonomik](#)
- [Angazhimi i organizatave të tjera](#)
- [Metodat e angazhimit të operatorëve ekonomik](#)
- [Shërbimet](#)
- [Informacion i mëtejshëm](#)

Autorizuar për botim nga Karen Hill, Drejtuese e Programit të SIGMA-s

Hyrje

Analiza e tregut, në kontekstin e prokurimit publik, është një proces i ndërmarrë nga një autoritet kontraktor ose në emër të tij për të mbledhur informacione që mund ta ndihmojë autoritetin kontraktor në përcaktimin e kërkesave të tij të prokurimit me anë të zgjedhjes së metodën më të përshtatshme të tenderimit, analizimit dhe vlerësimit të ofertave, dhe përcaktimit më efikas të rezultatit të ofertës ekonomikisht më të favorshme.

Termet e tjera të përdorura zakonisht për të gjithën ose për një pjesë të procesit të analizës së tregut janë si më poshtë: "studimi i tregut", "vlerësimi i tregut", "kërkimi i tregut" dhe "matjet e tregut".

Arsyet për kryerjen e një analize të tregut: analiza e plotë dhe të mirë-zhvilluar e tregut i jep autoritetit kontraktor informacion të vlefshëm për operatorët ekonomikë që do të jenë në gjendje që të përmbushin kërkesat e tij dhe rreth veprimtarisë së tregut. Autoriteti kontraktor mund ta përdorë informacionin e marrë nga analiza e tregut për të bërë zgjedhje të argumentuara se si ajo do ta kryejë prokurimin. Analiza e tregut mund të kontribuojë në mënyrë të konsiderueshme në menaxhimin efektiv të procesit të prokurimit dhe të rezultateve pozitive të realizimit të tij.

Grupi i instrumenteve të prokurimit i OECD-së tregon se avantazhet e analizës së tregut (të referuara në grupin e instrumenteve si "studimi i tregut") janë si më poshtë:

- "Ritja e ndërgjegjësimit për karakteristikat e tregut dhe për zhvillimet apo tendencat e fundit e tregut që mund të ndikojnë në konkurrencën e tenderimit, ose që mund të bëjnë më të mundshme marrëveshjet e fshehta (p.sh., numri i vogël i furnizuesve, produktet e standardizuara ose të thjeshta, pak ose aspak hyrje, etj.);
- Mbledhja e informacionit mbi furnitorët, produktet e tyre, çmimet dhe strukturat e kostos. Rekomandohet, nëse është e mundur, që të bëhet një krahasim i çmimeve të ofruara në prokurimin biznes-me-biznes;
- Mbledhja e informacionit në lidhje me ndryshimet e fundit të çmimeve. Kjo do t'i ndihmojë nëpunësit e prokurimit që të jenë të informuar në lidhje me çmimet në zonat gjeografike fqinje dhe rreth çmimeve të produkteve të mundshme alternative;
- Mbledhja e informacionit në lidhje me tenderat e fundit për produkte të njëjta ose të ngjashme;
- Koordinimi me autoritetet e tjera të prokurimit publik të cilat kanë blerë së fundmi mallra, shërbime ose punë të ngjashme për të përmirësuar të kuptuarit e tregut dhe furnizuesit."

<https://www.oecd.org/governance/procurement/toolbox/>

Kur duhet të kryhet analiza e tregut: analiza e tregut kryhet në fazën e planifikimit të një procedure prokurimi mjaft përpara fillimit të procedurës.

Analiza e tregut mund të bëhet në momente të caktuara gjatë vitit për blerjet që prokurohen në mënyrë të rregullt, ose ajo mund të ndërmerret si pjesë e planifikimit të një prokurimi të caktuar.

Procesi i analizës së tregut: Analiza e tregut mund të jetë një ushtrim i thjeshtë zyre për të mbledhur informacion, duke përfshirë shqyrtimin e një shumëllojshmërie të burimeve të informacionit në dispozicion të publikut rreth punëve, furnizimeve ose shërbimeve që janë objekt i prokurimit të propozuar dhe rreth tregut në të cilin ato janë të disponueshme.

Burimet në internet për analizat që realizohen në zyrë

Procurement Journey Scotland është një burim në internet që mirëmbahet nga Qeveria skoceze dhe që ofron udhëzime the thella, hap-pas-hapi në lidhje me proceset e prokurimit, duke përfshirë relacionet udhëzuese dhe modelet tip të dokumenteve.

Ky burim në internet përbëhet nga tre "rrugë" të prokurimit. Rrugët 1 dhe 2 kanë të bëjnë me prokurimin nën kufijtë monetarë të BE-së, ndërsa Rruga 3 lidhet me prokurimin mbi kufijtë monetarë të BE-së.

Rruga 3 parashikon në Seksionin A një mbulim të plotë të përgatitjeve për prokurim. Pjesa e Seksionit A për "Zhvillimin e Strategjisë" përfshin një nën-seksion mbi "Analizën e Tregut të Furnizimit", i cili ofron relacionet të dobishme udhëzuese dhe modele tip, si dhe një listë të burimeve të sugjeruara për kërkimin e tregut, si pjesë e procesit të analizës së tregut (shih "Dokumenti i furnizimi të tregut me burime" nën titullin "Burimet e jashtme për të dhënat e tregut të furnizimit").

Burimet e listuara janë specifike për Mbretërinë e Bashkuar, në veçanti për Skocinë, dhe janë pak të vjetruara, por ata ofrojnë një tregues të mirë të llojeve të burimeve të disponueshme në internet që mund të përdoren për një analizë tregu të bazuar tek zyra. Burimet e referuara përfshijnë organizata profesionale të blerjes; organizatat e sektorit publik, duke përfshirë edhe organet e krijimit të politikave dhe organizatat përfaqësuese; burimet e të dhënave ekonomike; informacion të përgjithshëm të kërkimit të tregut; dhe informacione të vështrimit të përgjithshëm të kompanive.

<https://www.procurementjourney.scot/procurement-journey>

Analiza e tregut mund të përfshijë edhe përfshirjen e drejtpërdrejtë të operatorëve ekonomik dhe të organizatave të tjera me ekspertizë më ekspertizë të rëndësishme, siç janë organet e tregtisë apo dhomat e tregtisë. Angazhimi i drejtpërdrejtë mund të plotësojë kërkimin që realizohet në zyrë duke siguruar njohuri të drejtpërdrejta nga operatorët ekonomik të tregut. Angazhimi i drejtpërdrejtë i operatorëve ekonomik zakonisht referohet gjithashtu edhe si "matja e tregut", "thithje e informacionit nga furnizuesit", apo "konsultimi paraprak i tregut".

Kujdes: Aty ku ka angazhim të drejtpërdrejtë ndërmjet autoritetit kontraktor dhe operatorëve ekonomik është shumë e rëndësishme që të sigurohet që procesi i angazhimit dhe rezultatet e angazhimit të drejtpërdrejtë të jenë transparente, të garantojnë trajtim të barabartë, të mos shtrembërojnë konkurrencën, dhe të minimizojnë rrezikun e korrupsionit.

Angazhimi i drejtpërdrejtë i operatorëve ekonomik trajtohet më poshtë, dhe informacioni jepet në kërkesat e Direktivës së Sektorit Publik 2014¹ (Direktiva) për të siguruar transparencë, trajtim të barabartë dhe konkurrencë.

Objekti i analizës së tregut: Grupi i instrumenteve të Prokurimit i OECD-së konfirmon se, së paku, analiza e tregut do të përfshijë në përgjithësi mbledhjen e informacionit për sa më poshtë:

- Strukturën e tregut
- Aftësitë e operatorëve ekonomikë
- Tendencat e çmimeve.

Shtirja dhe thellësia e procesit të analizës së tregut do të ndryshojnë në varësi të natyrës së prokurimit. Analiza e thjeshtë e realizuar në zyrë që përdoret për të sqaruar strukturën e tregut, identifikimin e operatorëve aktive ekonomike, dhe për të kuptuar çmimet mund të jetë një qasje e përshtatshme për prokurimin standard të materializuar.

¹ Direktiva 2014/24/BE për prokurimet publike dhe shfuqizimin e Direktivës 2004/18/KE, 26 shkurt 2014.

Në raste të tjera, analiza e tregut mund të jetë më e gjerë i gjerë dhe më e plotë. Autoriteti kontraktor mund të përdorë, për shembull, procesin e analizës së tregut për të shqyrtuar nivelin e inovacionit të mundshëm në treg kur kërkesat e autoritetit janë të pazakonshme apo komplekse, ose për ta ndihmuar atë në përgatitjet për përdorimin e metodës së kostos së ciklit të jetës për vlerësimin e një produkti. Për më shumë informacion mbi analizën e tregut dhe llogaritjen e kostos së ciklit të jetës shih Udhëzimin nr. 34 të SIGMA-s për Prokurimin Publik, *Kostoja e ciklit të jetës*.

Analiza e tregut mund të përdoret për të mbledhur informacion që mund të ndihmojë në marrjen e vendimeve strategjike për çështje të tilla si nëse dhe si të ndahen kërkesat e autoriteti kontraktor në lote, përshtatshmëria e marrëveshjes kuadër publike ose e blerjes dinamike, ose nëse do të përdoret apo jo procedurë konkurruese me negociim. Për më shumë informacion mbi lotet shih Udhëzimin nr. 36 të SIGMA-s për Prokurimin Publik, *Ndarja e kontratave në lote*.

Analiza e tregut mund të përshtatet për të mbledhur dhe analizuar të dhënat se si të arrihen objektivat më të gjera, siç është pjesëmarrja e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM), promovimi i inovacionit, apo mbështetja e objektivave sociale dhe ekonomike kur lejohen në bazë të rregullave të prokurimit të BE-së. Shih gjithashtu Udhëzimin nr. 33 të SIGMA-s për Prokurimin Publik, *NVM-të në Prokurimin Publik*.

Regjistrimi i procesit të analizës së tregut: Është e rëndësishme që të regjistrohet procesi i përdorur për të përgatitur dhe për të kryer analizat e tregut në mënyrë që brenda autoritetit kontraktor të ketë një kuptim të qartë të qëllimit dhe të synimeve të analizës së tregut dhe të nevojës për të siguruar transparencën e procesit dhe trajtimin e barabartë. Kjo është një ide e mirë për autoritetin kontraktor në mënyrë që ai të përgatisë dhe të përdorë dokumentin e analizës kërkimore të tregut për të identifikuar çështjet që duhen vlerësuar dhe procesin që do të ndiqet për të mbledhur informacionin e duhur.

Raporti i analizës së tregut: Në fund të procesit të analizës së tregut, autoriteti kontraktor përgatit një raport për analizën e tregut. Raporti do të jetë një pasqyrë transparente që rendit dhe shpjegon çështjet që janë shqyrtuar, që përfshin regjistrimin e burimeve kërkimore dhe informacionin që është përdorur, dhe përcakton konkluzionet e analizës së tregut.

Modelet tip

Grupi i instrumenteve të prokurimit i OECD-së – “Modeli tip i Raportit të studimit të tregut”

<https://www.oecd.org/governance/procurement/toolbox/templateformarketstudyreport.htm>

Procurement Journey Scotland – “Dokumenti i modelit tip për përmbledhjen e tregut”

<https://www.procurementjourney.scot/route-3/route-3-develop-strategy-profiling-commodity-supply-market-analysis>

Përfshirja e drejtpërdrejtë e operatorëve ekonomikë, si pjesë e analizës së tregut

Sipas Direktivës, autoriteti kontraktor mund të përfshijë drejtpërsëdrejti operatorët ekonomik si pjesë e analizës së tregut. Procesi duhet të jetë i planifikuar dhe i menaxhuar me shumë kujdes në mënyrë që të shmangen rreziqet e mungesës së transparencës, trajtimit jo të barabartë, ose të shtrembërimit të konkurrencës pasuese.

Në nenet 40 dhe 41 Direktiva përmban dispozita që lidhen me angazhimin e tillë të drejtpërdrejtë, duke përdorur termin "konsultime paraprake të tregut". Më poshtë jepet një përmbledhje e këtyre dispozitave së bashku me komentet.

Neni 40 - konsultimet paraprake të tregut: Neni 40 i Direktivës përcakton kontekstin e konsultimeve paraprake të tregut: "Para fillimit të një procedure të prokurimit, autoritetet kontraktore mund të bëjnë konsultime të tregut me qëllim të përgatitjes së prokurimit dhe të informimit të operatorëve ekonomikë lidhur me planet e tyre të prokurimit dhe prokurimet."

Autoritetet kontraktore lejohen, por nuk janë të detyruara, të përdorin konsultime paraprake të tregut. Qëllimi i konsultimeve paraprake siç përcaktohet në Direktivë është i dyfishtë:

- Të ndihmojë autoritetin kontraktor që të përgatisë prokurimin e tij duke përfshirë edhe mundësinë për të "kërkuar ose pranuar këshilla nga ekspertë ose autoriteteve të pavarura ose nga pjesëmarrësit e tregut", dhe t'i përdorë këto këshilla në planifikimin dhe zhvillimin e procedurës së prokurimit (me kusht që këto këshilla të mos kenë efektin e çrregullimit të konkurrencës dhe të mos rezultojnë në ndonjë shkelje të parimeve të mosdiskriminimit dhe transparencës);
- Të sigurojë informacion për operatorët ekonomik në lidhje me prokurimin e propozuar.

Neni 41 - përfshirja paraprake e kandidatëve ose ofertuesve: Neni 41 i Direktivës ka bërë me kandidatët ose ofertuesit me përfshirje paraprake në përgatitjen e procedurës së prokurimit. Referenca në nenin 41 të "përfshirjes paraprake" përmban dhënien e këshillave për autoritetin kontraktor në kuadër të konsultimeve paraprake të tregut ose përfshirje të tjera në përgatitjen e procedurës së prokurimit. Një shembull praktik i "përfshirjeve të tjera" është ofrimi i këshillave profesionale për përmbajtjen e një specifikimi teknik ose për strukturimin e procesit të prokurimit.

Neni 41 përshkruan një parim të rëndësishëm të vendosur nga Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Evropian (GJED): kandidati ose ofertuesi që ka pasur përfshirje të mëparshme mund të përjashtohet nga procedura e tenderit vetëm kur *nuk ka mjete të tjera* për të siguruar respektimin e parimit të trajtimi i barabartë të ofertuesve².

Kur autoriteti kontraktor vendos se duhet të përjashtojë një operator ekonomik në funksion të përfshirjes së tij paraprake në procedurën e prokurimit, atëherë operatorit ekonomik në fjalë duhet t'i jepet mundësia për të provuar se përfshirja e tij nuk do të shtrembërojë procedurën. Autoriteti kontraktor duhet të dokumentojë masat përkatëse të marra në një raport të veçantë të kërkuar sipas nenit 84 të Direktivës.

Prandaj, nuk lejohet që një autoritet kontraktor të përjashtojë automatikisht nga procedura e tenderit një kandidat ose ofertues që ka pasur përfshirje paraprake në procedurë. GJED-ja ka vendosur në disa raste³ se përjashtimi automatik është një reagim i tepruar dhe se legjislacioni kombëtar që kërkon përjashtimin automatik të operatorëve ekonomikë në rastet kur ka pasur përfshirje paraprake është i paligjshëm. Shih gjithashtu Udhëzimin nr. 7 të SIGMA-s për Prokurimin Publik, *Përzgjedhja e operatorëve ekonomik*, dhe Udhëzimin nr. 24 të SIGMA-s për Prokurimin Publik, *Përdorimi i listave të përjashtimit automatik*.

Autoriteti kontraktor është i detyruar të marrë dhe të dokumentojë "masat e duhura për të garantuar se konkurrenca nuk shtrembërohet nga pjesëmarrja e këtij kandidati ose ofertuesi". Neni 41 përcakton në një listë jo shteruese masat që duhet të marrë autoriteti kontraktor. Autoriteti kontraktor duhet:

- T'i japë të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve të gjithë informacionin përkatës që është shkëmbyer ose që rrjedh nga angazhimi paraprak. Kjo kërkesë është një përpjekje për të neutralizuar çdo avantazh të mundshëm që operatori ekonomik mund të ketë si rrjedhojë e përfshirjes së mëparshme;
- Të rregullojë afatet kohore të mjaftueshme për pranimin e ofertave. Kjo kërkesë synon të sigurojë që afatet e vendosura nuk janë shumë të shkurtra, gjë e cila mund të jetë e dobishme për një operator ekonomik me përfshirje dhe njohuri paraprake.

² SIGMA (2014), *Aktgjykime të zgjedhura të Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Evropian mbi Prokurimin Publik (2006-2014)*, Botimet e OECD-së, Paris. <http://www.sigmaxweb.org/publications/Judgements-CourtJustice-31July2014-Alb.pdf>

³ Po aty.

Vendimi për të angazhuar drejtpërsëdrejti operatorët ekonomikë

Autoriteti kontraktor duhet të shqyrtojë me kujdes nëse të përfshijë apo jo drejtpërsëdrejti operatorët ekonomik. Përfshirja e drejtpërdrejtë nuk është e përshtatshme në çdo rast. Kjo është e përshtatshme veçanërisht për projekte shumë komplekse ose të reja. Në disa raste është me vend që operatorët ekonomikë të përfshihen në mënyrë të drejtpërdrejtë si pjesë e procesit të analizës së tregut për të plotësuar informacionin e marrë në fazën e punës në zyrë.

Angazhimi i drejtpërdrejtë mund të jetë shumë i dobishëm për autoritetin kontraktor për të vlerësuar, për shembull, nëse kontrata e propozuar:

- Është e realizueshme nga pikëpamja teknike, financiare, ligjore dhe operacionale dhe mund të realizohet brenda afatit kohor të dëshiruar;
- Është realizuar më parë;
- Mund të realizohet nga një operator ekonomik ose kërkon më shumë se një operator në një zinxhir konsorciumi apo furnizimi.
- Përveç kësaj, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë:
 - Nëse ka apo jo një numër të mjaftueshëm furnizuesish në treg për të siguruar konkurrencë efektive;
 - Nëse kontrata të ngjashme janë në përgatitje apo jo në treg dhe kur do të vijnë ato në treg.

Ky informacion, i marrë nëpërmjet angazhimit të drejtpërdrejtë të operatorëve ekonomik, mund ta ndihmojë autoritetin kontraktor në përcaktimin dhe perfeksionimin e kërkesave të tenderit dhe në marrjen e vendimeve për afatet e procesit të prokurimit, zgjedhjen e procedurës së tenderit, si dhe për përdorimin e mjeteve të prokurimit. Angazhimi i drejtpërdrejtë mund të kursejë kohë dhe përpjekje, duke siguruar fokusimin në aktivitetet e mëvonshme të procesit të prokurimit. Kjo gjithashtu mund t'i mundësojë autoritetit kontraktor që vlerësojë çështjet e buxhetit dhe të kostove në mënyrë më saktë, të identifikojë risqet e kontratës dhe kapacitetin e tregut dhe çështje të tjera të cilat mund të ndikojnë në realizimin e kontratës, të nxisin inovacionin, dhe të ndihmojë në zhvillimin e një tregu të ri.

Siç është përmendur tashmë, autoritetet kontraktore duhet të jenë transparent në marrjen e vendimeve, dhe është e këshillueshme që ato të përgatisin një listë ose regjistrë të plotë që përfshin arsyet që justifikojnë një vendim për të angazhuar drejtpërdrejt operatorët ekonomik.

Identifikimi i operatorëve ekonomik

Autoriteti kontraktor duhet së pari të vendosë se si do të identifikohen dhe të angazhohen operatorët ekonomikë. Ky vendim mund të jetë mjaft i vështirë. Nga njëra anë, autoriteti kontraktor duhet të mbajë në mendje parimet e transparencës dhe të trajtimit të barabartë dhe të garantojë se nuk do të shtrembërohet konkurrenca e procesit të ardhshëm të prokurimit. Nga ana tjetër, ai duhet të përpiqet që të arrijë një angazhim kuptimplotë dhe edukativ të operatorëve ekonomik, në mënyrë që ai të mund të mbledhë informacion që është me të vërtetë i dobishëm për procesin e planifikimit të prokurimit.

Një qasje e përdorur në Bashkimin Evropian (BE) është shpallja e procesit të angazhimit të tregut në *Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian (GZBE)* duke përdorur Njoftimin Paraprak të Informacionit. Avantazhi i kësaj qasje është se mundësia është shpallur publikisht në nivel të BE-së dhe vihet në dispozicion të një tregu potencialisht shumë të madh pjesëmarrësish. Një disavantazh i kësaj qasjeje do të ishte numri i madh i operatorëve ekonomik që mund të dëshirojnë të marrin pjesë në procesin e angazhimit të tregut, gjë e cila mund të bënte që autoritetin kontraktor do t'i duhej që të menaxhonte sasi të madhe informacioni të marrë nga

operatorët ekonomikë. Operatorët ekonomikë mund të mos jenë të gatshëm që të japin informacion të dobishëm në qoftë se ata besojnë se do informacioni do të ndahet gjerësisht me konkurrentët e tyre.

Autoritetet kontraktore mund ta vlerësojnë më të efektshme që të kontaktojnë operatorë të njohur ekonomik drejtpërdrejt në mënyrë konfidenciale, duke kufizuar pjesëmarrjen në procesin e angazhimit të tregut. Avantazhi i kësaj qasjeje është se ajo mund të çojë në diskutime më të hapura me operatorët ekonomik. Megjithatë, një disavantazh i madh është se ka të ngjarë që kjo të shihet si mungesë transparence dhe për këtë arsye kjo mund të sjellë akuzat për trajtim të pabarabartë ose edhe korrupsion.

Angazhimi i organizatave të tjera

Analiza e tregut mund të përfshijë edhe angazhimin e organizatave të tjera. Për shembull, autoriteti kontraktor mund ta shohë të dobishme që të angazhojë një organizatë aktive tregtare në vend që të angazhojë operatorët ekonomikë individualë. Mënyrë alternative mund të ishte shpallja e mundësisë së pjesëmarrjes së tregut të gjerë, por më pas kjo të kufizohej në pjesëmarrjen e një numri maksimal të operatorëve ekonomikë të përzgjedhur në mënyrë të rastësishme. Megjithatë, çdo proces i përzgjedhjes ka të ngjarë të rrisë rrezikun e kundërshtimit ligjor.

Metodat e angazhimit të operatorëve ekonomik

Ka mënyra të ndryshme për të angazhuar operatorët ekonomik. Ajo çfarë është e përshatshme do të varet nga natyra e prokurimit dhe nga objektivin që autoriteti kontraktor dëshiron të arrijë nga procesi i angazhimit të drejtpërdrejtë. Disa shembuj janë paraqitur më poshtë.

Shënim i rëndësishëm: Është shumë e rëndësishme që kur planifikohet angazhimi i drejtpërdrejtë të mbahen parasysh kërkesat kyçe të respektimit të parimeve të mosdiskriminimit dhe të transparencës dhe se procesi nuk do të shtrembërojë konkurrencën e më pasme. Në të gjitha rastet është shumë e rëndësishme që të mbahen shënime të qarta të procesit të ndjekur dhe të informacionit të dhënë.

Kontakti i realizuar në zyrë: angazhimi i drejtpërdrejtë i operatorëve ekonomikë mund të jetë thjesht një ushtrim që realizohet në zyrë. Në këtë rast, autoriteti kontraktor mund të shqyrtojë përdorimin e një pyetësi të përshtatur për prokurimin e veçantë që i dërgohet operatorëve ekonomikë duke kërkuar përgjigje brenda një kohe të caktuar. Nëse autoriteti kontraktor preferon të përgjigjet në mënyrë anonime për të shmangur rrezikun e preferencave të dyshuara për një operator të caktuar ekonomik, atëherë mund të përdoret, për shembull, një pyetësor anonim në internet ku përgjigjet analizohen nga një palë e tretë e pavarur. Një portal i bazuar në internet është një tjetër metodë e mundshme.

Grupi i instrumenteve të prokurimit i OECD-së përfshin një “Model tip për thithjen e informacionit të furnitorëve”:

<https://www.oecd.org/governance/procurement/toolbox/templatetosolicitsupplierinformation.htm>

Kontakti me telefon: angazhimi i drejtpërdrejtë mund të përfshijë edhe kontaktin e drejtpërdrejtë me telefon. Ekipi i prokurimit i autoritetit kontraktor të mund të kryejë intervista telefonike bazuar në një grup standard pyetjesh dhe i regjistron përgjigjet me shkrim të marra në mënyrë anonime. Për të siguruar trajtim të barabartë, autoriteti kontraktor mund të organizojmë, për shembull, që të gjitha intervistat telefonike të bëhen nga një organ i pavarur ku autoritetit kontraktor i jepet një përmbledhje e reagimeve anonime.

Ditët e hapura: Në disa raste mund të jetë e përshtatshme për të organizuar ditë të hapura për operatorët e interesuar ekonomik. Ditë të tilla mund të jenë të dobishme në rastet kur kërkesat e autoritetit kontraktor nuk janë standarde ose kërkojnë inovacion ose kur është e rëndësishme për operatorët ekonomikë që ata të shohin në të vërtetë vendndodhjen gjeografike të realizimit të kontratës. Për të zgjeruar mundësinë që të marrin pjesë sa më shumë operatorë ekonomik që të jetë e mundur, është parë me vlerë organizimi i një aktiviteti që do të jetë i aksesueshëm në një format të bazuar në internet.

Rast studimor: Projekti PFI i ndriçimit publik i Këshillit të Qarkut të Dorsetit - Konsultimi i tregut

Në vitin 2004 Këshilli i Qarkut të Dorsetit në Mbretërinë e Bashkuar zhvilloi një rast biznesi për projektin e tij afatgjatë të ndriçimit të rrugëve PFI. Menjëherë pas rasti u miratua, Këshilli organizoi një aktivitet për konsultimin e tregut, gjatë së cilit ishte planifikuar që të takoheshin me furnizuesit që do të ishin të interesuar që të merrnin projektin. Aktiviteti u shpallur në shkallë mbarëkombëtare ku shpallja u publikuar në mediat kombëtare dhe në shtypin teknik.

Aktiviteti një-ditor u organizuar në Londër dhe u fokusua në promovimin e Këshillit të Qarkut të Dorsetit si një prokurues i mirë. Për të promovuar Këshillin në mënyrë efektive, Dorseti bashkëpunoi me ekspertë vendas të prokurimit qeveritar dhe me 4P-të (një organ këshillimor i specializuar i sektorit publik për PFI/PPP) si dhe ftoi gjithashtu edhe përfaqësuesin e Departamentit të Transportit për të bërë një prezantim me këtë rast. Veprimtarinë e cila u hap nga një anëtar të kabinetit e ndoqën rreth 20 dhe 30 lojtarë kryesorë të industrisë.

Aktiviteti përbëhej nga prezantime që theksonin si qëllimin strategjik ashtu edhe aspektet teknike të projektit. Më pas vazhduan një seri diskutimesh dhe çështjesh që lidheshin me projektin, gjë e cila i mundësoi Këshillit të Qarkut të Dorsetit që të merrte kontribute dhe reagime për qasjen e tij të synuar. Pjesëmarrësit gjithashtu patën mundësinë e paraqitjes së reagimeve me shkrim pas aktivitetit, nëse ata nuk donin që t'i diskutonin disa çështje përpara konkurrentëve të tyre.

Përveç promovimit të vet para industrisë, Këshilli i Qarkut të Dorset fitoi me anë të këtij aktiviteti një përqendrim më të madh dhe njohuri për tregun, dhe ishte në gjendje që të vlerësonte interesin e bazës së furnizimit në projekt. Ai mori gjithashtu edhe reagime të dobishme nga furnizuesit e mundshëm, të cilët i mundësuan atij që të përcaktonte dhe të zhvillonte më tej qasjen e tij strategjike.

Burimi: Zyra në Mbretërinë e Bashkuar për Tregtinë Qeveritare (2009), "Parimet e angazhimit të hershëm të tregut dhe shembuj të praktikës së mirë".

http://webarchive.nationalarchives.gov.uk/20100503135839/http://www.ogc.gov.uk/documents/Early_Market_Engagement_Guidance.pdf

Transparenca dhe trajtimi i barabartë: I gjithë informacioni i dhënë operatorëve ekonomik gjatë një dite të hapur duhet të jetë në dispozicion të kandidatëve dhe ofertuesve në procesin e mëvonshëm të tenderit. Informacioni i dhënë në ditën e hapur duhet të vihet në dispozicion si pjesë e dokumenteve të prokurimit në datën e publikimit të njoftimit të kontratës në *GZBE*, pa pagesë në internet. Mund të jetë gjithashtu e përshtatshme që të jepet një lidhje në internet për regjistrimin direkt të aktivitetit në mënyrë që operatorët ekonomik që nuk kanë qenë në gjendje që të marrin pjesë në aktivitet të kenë mundësi të dëgjojnë prezantimet dhe diskutimet.

Shërbimet

Direktiva e Shërbimeve⁴ përdor të njëjtin formulim si në Direktivë:

- Neni 58 - konsultimet paraprake të tregut;
- Neni 59 - përfshirja paraprake e kandidatëve ose ofertuesve.

⁴ Direktiva 2014/25/BE për prokurimet nga subjektet në sektorin e ujit, energjisë, transportit dhe sektorëve të shërbimeve postare dhe shfuqizimin e Direktivës 2004/17/KE, 26 shkurt 2014.

Informacion i mëtejshëm

Botime

SIGMA (2015), *Manual i trajnimit të prokurimit publik* – Modulet A1, A2 dhe A3, Botimet e OECD-së, Paris, <http://www.sigmaweb.org/publications/public-procurement-training-manual.htm>

SIGMA (2014), *Aktgjykime të zgjedhura të Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Evropian mbi Prokurimin Publik (2006-2014)*, Botimet e OECD-së, Paris.
<http://www.sigmaweb.org/publications/Judgements-CourtJustice-31July2014-Alb.pdf>

Udhëzimet e Prokurimit Publik

<http://www.sigmaweb.org/publications/key-public-procurement-publications.htm>

SIGMA (2016), *Ndarja e kontratave në lote*, Udhëzimi 36, Botimet e OECD-së, Paris.

SIGMA (2016), *Llogaritja e kostos së ciklit të jetës*, Udhëzimi 34, Botimet e OECD-së, Paris.

SIGMA (2016), *NVM-të në prokurimin publik*, Udhëzimi 33, Botimet e OECD-së, Paris.

SIGMA (2016), *Përdorimi i listave të përjashtimit automatik*, Udhëzimi 24, Botimet e OECD-së, Paris.

SIGMA (2016), *Përzgjedhja e operatorëve ekonomik*, Udhëzimi 7, Botimet e OECD-së, Paris.